



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1005/Prot.
12

Tiranë, më 06/11 /2015

VENDIM

Nr. 49, datë 06/11 /2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 4,7,8,10 dhe 18 të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", 31/1/c të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, dhe nenit 16 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Me urdhrin nr. 204., datë 09.10.2015, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale urdhëroi fillimin kryesisht të hetimit administrativ në datë 13.10.2015, pranë Autoritetit Publik/ Drejtoria e Përgjithshme Detare, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit".

Objekti i hetimit administrativ ishte verifikimi i përmbushjes së detyrimeve të Autoritetit Publik:

- 1) për përgatitjen, miratimin dhe bërjen publike të programeve të transparencës, në zbatim të nenit 4 të ligjit për të drejtën e informimit;
- 2) përmbushja e detyrimit për vënien në dispozicion të publikut në faqet e tyre në internet, kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë, në zbatim të nenit 7 të ligjit;
- 3) përmbushja e detyrimit për krijimin, mbajtjen dhe bërjen publike të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, në zbatim të nenit 8-të;
- 4) përmbushja e detyrimit për caktimin e Koordinatorit për të drejtën e informimit, në zbatim të nenit 10 të këtij ligji.

Pas verifikimeve në faqen zyrtare të autoritetit publik si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e përfaqësuesve të tij, grupi i inspektimit konstatoi se :

- detyrimi për përgatitjen dhe miratimin e programeve të transparencës nuk është përmbushur;
- detyrimi për vënien në dispozicion të publikut në faqet e tyre në internet, kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë nuk është përmbushur;
- krijimin, mbajtjen dhe bërjen publike të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve nuk është përmbushur;
- caktimin e Koordinatorit për të drejtën e informimit nuk është përmbushur.

Në zbatim të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", në prani të Z.

, drejtor i Përgjithshëm, u mbajt procesverbali i hetimit administrativ në të cilin u paraqitën të gjitha konstatimet e grupit të inspektimit. Z. *parashtrori se është kërkuar periodikisht shtesë në organikë për një person IT për mbulimin e funksioneve të informimit publik, por pamundësia e burimeve njerëzore shkakton deficiencat e evidentuara...kemi predispozicionin maksimal të lëvizim konformë këtij ligji".*

Sipas nenit 4 të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" Autoriteti Publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji vë në zbatim programin e transparencës. Drejtoria e Përgjithshme Detare, brenda datës 4 Maj 2015, që i përket datës së hyrjes në fuqi, duhet të kishte hartuar dhe miratuar programin e transparencës.

Sa më sipër, bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 18 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik/ Drejtoria e Përgjithshme Detare duhet të sanksionohet me gjobë për mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, objekt i këtij procesi administrativ.

Në zbatim të pikës 1 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" përgjegjësia për kundërvajtjet administrative i takon titullarit të autoritetit publik për mosvënien në zbatim të programit institucional të transparencës.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën b) të pikës 2 të nenit 18, pikës 1 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

V E N D O S A:

1. Dënimin e Z. , titullar i autoritetit publik/ Drejtorisë së Përgjithshme Detare me gjobë në vlerën 50 000 lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
2. Kundër këtij vendimi personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, në përputhje me nenin 22 të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe pikën 3 të nenit 72 të ligjit nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".
3. Ky vendim i njoftohet Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe Zyrës së Financës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare.
4. Gjyba ekzekutohet nga zyra e financës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv.
5. Ky vendim u dha sot në datë 06.11.2015.

